Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**04.01.2024**	**16.01.2024**	**2023/1068**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.12.2023, OE "„Menti Sh.p.k."- Istog, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1068, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i hapesires rreth shtatoreve te kater Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RITENDER" me nr. të prokurimit: "635-23-12223-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 281,967.50 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 03/11/2023

Hapja e ofertave: 27/11/2023

Vendimi i AK-së: 11/12/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1068 i dt:29.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimi i pare

Shkelje e nenit 60 , paragrafi 1.2

AK – gjate procesit te Vleresimit te Tendereve ka konstatuar se jemi 2 Oferta konkuruese dhe te dyja te pergjegjshem , nuk ka proceduar me paragrafin 1.2 te keti neni. Pra AK ka shkele nenin 60 paragrafin 1.2

Pretendimi i dyte

Shkelje e nenit 62 , paragrafi 2.2

AK – me rastin e njoftimit ne Vendimin e dates 11.12.2023 eshte thirre ne Nenin 62 paragrafi 2.2 , ku ne asnjeren nga thenjet e keti paragrafi nuk gjene Arsyetimin per Anulim te AP
Vlenë të theksohet se Aktiviteti i Prokurimit ne fjalë edhe një here brenda keti viti eshte anuluar ne munges te ofertave konkuruese .

Citojm paragrafin 2.2 :

Neni 62 i Lpp-së paragrafi 2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

AK gjate Procesit te Anulimit gabimishte eshte thirre ne kete nen dhe ne kete paragrafi sepse ne FDT e ka te theksuar ne piken 5.2 se afati i permbushjes se kontrates eshte 365 dite kalendarike qe i bie se ky projekt eshte buxhetuar per vitin 2023 dhe 2024 thenja se gjoja grantet qeveritare nuk mund te shfrytezohen kete vite nuk qendron sepse AP eshte inicuar me daten 03.11.2023 dhe hapja e ofertave me daten 27.11.2023 qysh para hapjes se ofertave eshte dite shume qarte se shfrytezimi i mjeteve bugjetore per vitin fiskal 2023 eshte pothuajse i pamundur , per arsye te procesit i cili duhet te kaloj te gjitha fazat , vleresimi i ofertave , njoftimi i kandidateve mbi rezultatin e vleresimit , afatet ligjore ne pritje te ndonje Kerkese per Ri-Shqyrtim do te ishte e pa mundur qe kontrata te nenshkruhet para 15.12.2023 . Pra Vendimi i AK eshte i padrejte dhe na atakon neve si OE qe kemi ofruar çmimin me te ulet dhe jemi Ekonomikishte me i favorshem sepse kemi ofruar afatin me te gjate te kerkuar nga AK dhe nga komisioni jemi vlewresuar me 100 piket e mundshme per kete AP dhe jemi te pergjegjshem ish dashte te na a rekomandoj per dhenje te kontrates .
Rregullorja e Prokurimit Publik nr.01/2022 konkretishte neni 43 pika 43.5 e qarteson se ne cilat raste AK mund te nderpres AP , **dhe jo sikurse tani pas hapjes se ofertave dhe kur ka 2 Oferta te pergjegjshme , te vleresuara nga vete AK .**

Pas pranimit te kesaj kerkese per Ri-Shqyrtim Autoriteti Kontraktues duhet te analizoj fillimishte pretendimet tona , duke u bazuar ne nenin 108/A konkretishte piken 6 pa-vones duhet te aplikoj piken 8 te keti neni e me pastaj te merr :

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa 1 **Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjajeshme në vler prej 320.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.** **Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3 vitet e shkuara.**	**Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve.**
Kërkesa 2 **Menaxheri i projektit Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtaris drejtimi Konstruktiv me provoj pune minimum 5 vjeqare.**	**Dëshmia 2 Për Menaxherin e projektit (inxhinieri) duhet te ket Diplomen-kopje , me kontrat apo parakontrat ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt-e notrizuar ne prani te noterit nderjmet dy paleve ,vendim për Projekt menagjer i vulosur dhe nenshkruar nga Kompania si dhe CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri**
Kërkesa 3 Stafi i lartë profesional që do të kyqet në projekt minimum 3 inxhinerë - Një (1) inxhinjer i diplomuar ose Master i Arkitektures minimum 5 vite përvoj pune pas diplomimit. -	**Dëshmia 3 Për stafin professional (inxhinierët) duhet te ken Diplomat-kopje,si dhe per teknikun çertifikaten kopje , kontrata apo parakontrat ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt-e notrizuar ne prani te noterit nderjmet dy paleve dhe CV-ja e nenshkruar nga vet inxhinjeri.**

Një (1) inxhinjer i diplomuar ose Master i Hidroteknikes minimum 1 vite përvoj pune pas diplomimit. - Një (1) teknik i diplomuar i ndertimtaris i çertifikuar per perdorim te mjeteve dhe masat per mbrojtje ne pune minimum 2 vite përvoj pune pas diplomimit.	
Kërkesa 4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca -ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë -ISO 45001 2015 - Certifikata për menaxhimin e shëndetit në punë EN -ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemet e menaxhimit të cilësisë -ISO 50001 2018 - Certifikata për Sistemet e menaxhimit të energjisë Vrejtje Çertifikatat e natyres se njejt ISO më të avansuara pranohen	**Dëshmia 4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i paijisur me Certifikatat ISO valide (kopje)**
Kërkesa 5 Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit ne dosje te tenderit tek Aneksi 1	**Dëshmia 5 Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit. Vërejtje Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E PROKURIMIT
KOMUNA E PEJËS

Njesia e Prokurimit

Peje, datë, **19.12.2023**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejes, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **18.12.2023** me titull **Rregullimi i hapesires rreth shtatoreve te kater Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RITENDER** Nr. të Prok: **635-23-12223-5-2-1** dhe nr i brendeshen **635-23-085-521**nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik **„Menti Sh.p.k.** " . të datë **18.12.2023** lidhur me aktivitetin e prokurimit **Rregullimi i hapesires rreth shtatoreve te kater Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RITENDER** Nr. të Prok: **635-23-12223-5-2-1** dhe nr i brendeshen **635-23-085-521** nxjerr:
kundër **B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK PER ANULIM** , të datës **11.12.2023** te publikuar ne platëformen elektronike të E- Prokurimit .
Vërtetohet vendimi i A.K mbi **B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK PER ANULIM** të publikuar me datë: **11.12.2023**

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **„Menti Sh.p.k..** me daten **18.12.2023**, ka parashtruar kërkesen për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: **Rregullimi i hapesires rreth shtatoreve te kater Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RITENDER** me Nr. të Prok: **635-23-12223-5-2-1** nr i **635-23-085-521** nxjerr:

Autoriteti Kontratkues , me datën **19.12.2023** ka shqyrtuar kërkesen në fjalë si më poshtë:

A.K pas analizes se kerkeses se juaj për **Ri-shqyrtim** duke marr për bazë kërkesen tuaj në platformen elektronike të datës: **18.12.2023** ,e ka trajtuar me kujdes kërkesen tuaj, dhe ka ardhur ne perfundim se njejta eshte e **pa bazuar**.,

Ju njoftojm se ne si A.K kemi mar konfirmimin nga ZKF-ja me daten 27.11.2023 qe per projektin e lart cekur nuk kemi mjete per realizimin e projektin per vitin 2023 dhe 2024 pasi qe mjetet per kete A.P jan ndar nga grandi qeveritar dhe mjetet jan terhequr nga permbaruesit dhe pa mundesia e mjeteve ne si A,K planifikimin per hapjen e tenderit ka qene me daten 27.11.2023 ne ora 13:30 dhe ne pa mundesi e anulimit te A.P me daten 27.11.2023 ne si A,K kemi mar vendim per anulim e procedure me daten **11.12.2023** dhe ne pajtim me **Nenin 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit**

Andaj A.K ka analizuar me kujdese kete A.P dhe me kordinim me **ZKF-ne** dhe **ZKA-ne** eshte e pa mundur lidhja e kontrates dhe egzekutimi i punimeve brenda afatit te cilat dot mundesojne shfrytezimin e mjeteve nga grandi qeveritar te planifikuar per vitin 2023, dhe keto mjete A,K, mjetet per kete A,P nuk mund ti kete ne dispozicion ne bugjetin e perfshir per vitin 2024, nga Grandi Qeveritar dhe ne si A.K nuk mund te hym ne borgje per vitin 2024 per realizimin e keti A.P

Prandaj A.K ka mar vendim per **ANULIMIN** e procedures dhe shkaqe te pa mundesis Finaniciare

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato qe u thane me lartë ka vendosur si ne dispozitiv Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet te dorezohet brenda afatit ligjor .

Me respekt Prokurimit KK Peje

Vendimi i dorëzohet:

1. Një (1) kopje ngarkohet për mes platformës elektronike
2. Një (1) kopje – Arhivës A.K Komuna e Pejës.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **„Menti Sh.p.k.**

Sqarim hyrës: AK ka anuluar procedurën e prokurimit pas hapjes së ofertave, duke u thirrur në nenin 62 të LPP-së, pika 2.2. OE ankues si palë e pakënaqur me këtë vendim, ka ngritur disa pretendime për të cilat do të marr përgjigje nga eksperti shqyrtues si më poshtë.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: *"AK-gjate procesit te Vleresimit te Tendereve ka konstatuar se jemi 2 oferta konkuruese dhe te dyja te pergjegjshem, nuk ka proceduar me paragrafin 1.2 te ketij neni. Pra AK ka shkele nenin 60 paragrafin 1.2."*

Sa i përket këtij pretendimi, eksperti sqaron se ky nuk është një pretendim ankimor sepse nuk përmban fakte dhe as prova të cilat mund të shqyrtohen nga ana e ekspertit, për të vlerësuar se a qëndron apo jo ky pretendim.

Pretendimi 2

"AK- me rastin e njoftimit me Vendimin e dates 11.12.2023 eshte thirre ne Nenin 62 paragrafi 2.2, ku ne asnjeren nga theniet e këtij pragrafi nuk gjene Arsyetimin per Anulim te AP. Vlenë të theksohet se Aktiviteti i Prokurimit ne fjalë edhe një here brenda ketij viti eshte anuluar ne munges te ofertave konkuruese. AK gjatë procesit të anulimit, gabimisht eshte thirr ne nenin 62 të LPP-së, pragrafi 2.2 sepse FDT e ka te theksuar piken 5.2 se afati i permbushjes se kontrates eshte 365 dite kalendarike qe i bie se ky projekt eshte buxhetuar per vitin 2023 dhe 2024 thenja se gjoja grantet qeveritare nuk mund te shfrytezohen kete vit nuk qendron sepse AP eshte iniciuar me daten 03.11.2023 dhe hapja e ofertave me daten 27.11.2023 qysh para hapjes se ofertave eshte dite shume qarte se shfrytezimi i mjeteve buxhetore per vitin fiscal 2023 eshte pothuajse i pamundur, per arsye te procesit i cili duhet te kaloj te gjitha fazat, vleresimi i ofertave, njoftimi i kandidateve mbi rezultatin e njoftimit, afatet ligjore ne pritje te njdonje kerkese per rishqyrtim do te ishte e pa mundur qe kontrata te nenshkruhet para 15.12.2023."

Eksperti pasqyron se me datën 11/12/2023 AK ka marr vendim për anulim të procedurës së prokurimit në pajtim me nenin 62, pika 2.2 të LPP-së, me arsyetimin se: citim *"Është e pamundur lidhja e kontratës dhe ekzekutimi i punimeve brenda afatit të cilat do të mundësojnë shfrytëzimin e mjeteve nga grandi qeveritar të cilat kanë qenë të planifikuara për vitin 2023 dhe këto mjete AK nuk mund t'i ketë në dispozicion në buxhetin e përfshirë për vitin 2024, nga Grandi Qeveritar dhe nga të hyrat e KK Pejë. Prandaj AK ka marrë vendim për ANULIMIN e procedurës dhe shkaqe të pamundësisë Financiare".* Duke u bazuar në pikën 2.2 të nenit 62 të

LPP-së, ky nen flet për anulimin e procedurës së prokurimit para hapjes së tenderëve, AK në rastin konkret ka bërë hapjen e tenderëve dhe procesverbali i hapjes mund të gjendet i bashkëngjitur edhe në sistemin e-prokurimi, pra që do të thotë se kjo pikë e këtij neni nuk mund të vlejë për këtë rast. Për më tepër eksperti sqaron se AK ka publikuar njoftimin për kontratë më datë 03/11/2023 dhe në DT e ka cekur se afatet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës është 365 ditë kalendarike, në po të njëjtën datë është nënshkruar edhe deklarata e nevojave me shumën e paraparë për këtë procedurë. Vetëm pas 24 ditësh, AK në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga OE ankues pranon faktin se me datën 27/11/2023, ka marrë konfirmimin nga ZKF që për projektin e lartcekur nuk kemi mjete për realizimin e projektit pasi që mjetet janë tërhequr nga përmbaruesit, mirëpo AK nuk ka nxjerrë vendimin e anulimit deri më datë 11/12/2023.

Sipas ekspertit një veprim i tillë nga AK nuk është aspak korrekt dhe tregon një jo seriozitet të lartë nga ana e tyre. Siç edhe kanë qenë në dijeni, granti qeveritar i cili është planifikuar të përdoret për këtë procedurë prokurimi, ka vlejtur për vitin 2023 dhe publikimi i Njoftimit për Kontratë për më pak se dy muaj para përfundimit të vitit po ashtu nuk duket në rregull. Si çdo procedurë tjetër prokurimi e cila zhvillohet, AK është dashur të parashikoj se njësoj edhe me këtë procedurë mund të ketë vonesa në ofertim si pasojë e ndonjë kërkese për rishqyrtim apo ankese në kriteret e DT-së, apo vonesa pas ofertimit dhe publikimit të rezultateve përfundimtare. Për më tepër, mjetet të cilat janë ndarë për një aktivitet të caktuar, nuk mund të orientohen për një aktivitet tjetër. Mjetet të cilat janë tërhequr nga përmbaruesit nuk kanë lidhje me mjetet të cilat janë ndarë si grant i qeverisë, këto mjete të cilat janë parparë për një aktivitet nuk mund të përdoren si shlyerje e borxheve të caktuara për detyrime të tjera. Granti i cili është ndarë për periudhën një vjeçare, vlenë për periudhën e ndarë deri në fund të atij viti.

Edhe një herë për të sqaruar, thirrja e AK-së në nenin 62, pika 2.2 e LPP-së për anulim të kësaj procedure të prokurimit është e gabuar sepse kjo pikë përshkruan veprimin e AK-së në rastin para se të bëhet hapja e ofertave dhe jo pas hapjes siç është rasti konkret. Anulimi i procedurës së prokurimit duke u thirrur në këtë nen, nuk është në përputhje me LPP-në. Andaj, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **„Menti Sh.p.k.**

Agnese Ibrahimi